



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Nr. i Org. Org. Jendrica Org. Unit	SP-02
Nr. Prot. Org. Prot. Prot. No.	550-2/26
Nr. i fletëve Broj. listrika No. pages	-06-
Data. Datum: Date.	12.08.2026
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	02.06.2026
REFERENC-Ë:	26/550/85/DMM
PËR/ZA/TO:	"Erona Company" Sh.p.k. Rogovë, Gjakovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 26/550/85/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1.Vendimi për **Lejimin e Pëlqimit Mjedisor** kërkesës së Kompanisë "Erona Company" Sh.p.k. Rogovë, Gjakovë për të u pajisur me Pëlqim Mjedisor për thertoren dhe mishtore në Rogovë I Gjakovë.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958-4/23 datë 21.04.2026), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Kompania "Erona Company" Sh.p.k. Rogovë, Gjakovë me nr. prot. 26/550/85/DMM, për thertoren dhe mishtore në ngastrën kadastrale nr. P-70713071-01070-0 në Rogovë I, Gjakovë **pajiset me Pëlqim Mjedisor** me kushtet në vijim:

I. Mbrojtja e Ujërave dhe Trajtimi i Ujërave të Ndotura

Mbulimi i kanaleve: Të gjitha kanalet e kullimit brenda dhe jashtë hapësirave të thertores/mishtores duhet të jenë të mbuluara për të siguruar rrjedhjen normale të ujërave të ndotura në rrjet.

Separatorët e yndyrës dhe gjakut: Obligohet instalimi i separatorëve për yndyrë dhe sistemit për kapjen e gjakut para shkarkimit në kanalizim. Ndalohet **reptësisht** shkarkimi i drejtpërdrejtë i gjakut në ujëra.



Impianti i trajtimit: Të ndërtohet dhe operohet impianti për para-trajtimin fizik dhe biologjik të ujërave të procesit teknologjik (për uljen e vlerave të BOD₅, COD dhe lëndëve të suspenduara).

Monitorimi i shkarkimeve: Të bëhet monitorimi periodik i cilësisë së ujërave të shkarkuara (2 deri 4 herë në vit përmes laboratorit të licencuar) dhe rezultatet t'i raportohen Ministrisë.

Zona e mbrojtur ujore: Ndalohet çdo aktivitet dhe ndërtim i objekteve në një distancë prej së paku 30 metra nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve (në përputhje me Nenin 48 të Ligjit për Ujërat Nr. 04/L-147).

II. Menaxhimi i Mbetjeve Organike dhe të Ngurta (Nënproduktet Shtazore)

Izolimi i hapësirave prodhuese: Të betonohet dhe izohet plotësisht sipërfaqja e hapësirave prodhuese, depove të lëndës së parë, hapësirës së gjeneratorit dhe parkingut.

Ndarja dhe ruajtja e mbetjeve: Mbetjet organike (lëkurët, thonjtë, kockat, organet e papërdorshme, përmbajtja e stomakut) duhet të ndahen në mënyrë rigorozë dhe të grumbullohen në kontejnerë të mbyllur hermetikisht dhe të ftohur.

Kontrata me operatorë të licencuar: Ndalohet rreptësisht hedhja e mbetjeve shtazore në natyrë apo në kontejnerë komunalë. Kompania duhet të ketë kontratë valide me operator të licencuar për transportin e nënprodukteve shtazore drejt impianteve të asgjësimit.

Menaxhimi i plehut: Plehu nga stallat e pritjes dhe përmbajtja e stomakut të kafshëve të grumbullohen në një platformë betoni të mbuluar dhe të izoluar (për të parandaluar rrjedhjen në nëntokë).

III. Parandalimi i Erërave, Ndotjes së Ajrit dhe Kimikatat

Ventilimi dhe filtrimi: Hapësirat e therrjes dhe përpunimit duhet të pajisen me sisteme efikase të ventilimit me filtra të karbonit aktiv ose bio-filtra për minimizimin e erërave të pakëndshme.

Mirëmbajtja e stallave: Stallat e pritjes së kafshëve duhet të pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht për të parandaluar emetimet e amoniakut.

Emetimet nga kaldaja: Të sigurohet që emetimet e gazrave (SO₂, NO_x, CO dhe pluhuri) nga kaldaja të jenë brenda normave të lejuara dhe lartësia e oxhakut të jetë sipas standardeve teknike.



Përdorimi i kimikateve dhe DDD: Për pastrim të përdoren vetëm produkte të certifikuar biodegraduese (të ruajtura në sfonde të siguruara/bunds). Operatori duhet të zbatojë rregullisht masat e Dezinfektimit, Deratizimit dhe Dezinseksionimit (DDD) përmes kompanive të autorizuar.

IV. Masat Emergjente

Plani rehabilitues: Të hartohet dhe zbatohet plani për masat rehabilituese në rast të ndonjë ndotjeje apo dëmtimi aksidental të mjedisit gjatë dhe pas zbatimit të projektit.

Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura duhet t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (anulohet).

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar nga Kompania "Erona Company" Sh.p.k. Rogovë, Gjakovë me nr. prot. 26/550/85/DMM, për Pëlqim Mjedisor për thertoren dhe mishtore në ngastrën kadastrale nr. P-70713071-01070-0 në Rogovë I, Gjakovë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet konform nenit 29 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.
Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.



Vërejtje: Vonesa në dhënien e përgjigjes është shkaktuar si rezultat i volumit të madh të kërkesave në procedurë dhe ndryshimit të përbërjes së Komisionit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM). Informohet se shqyrtimi i lëndës deri në fazën e mbajtjes së debatit publik është kryer nga Komisioni paraprak.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/550/- ZSP/ /26 datë: 02.06.2026

Prishtinë



Bajram Kafexholli

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Gjakovës
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
9. Arkivit të MMPH

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH

